



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

**RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK -
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

1. Përmbledhja ekzekutive

Për vitin 2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kishte planifikuar 11 projektakte për konsultim publik, por ndërkohë realizoi konsultim publik për 6 projektakte, ndër të cilat 4 projektligje, dhe 2 projektvendime (1 strategji dhe një dokument strategjik kombëtar).

Ndërsa për disa projektakte të tjera të cilat u miratuan në vitin 2020, dhe mund të ishin pjesë e konsultimit publik sqarojmë si më poshtë vijon:

1. Projektligji për “Krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore- është një akt i mbartur, dhe konsultimi publik për këtë akt është bërë në vitin 2019. Duke marrë në konsideratë, se ky u konsultua njëherë, dhe vetëm për shkak të dakordësisë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, u miratua në 2020, u vlerësua jo i nevojshëm të ri hidhej në sistem për konsultim publik. Për këtë projektakt nuk pati komente.

2. Projektligji "Për krijimin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor" është një akt i mbartur, dhe konsultimi publik për këtë akt është bërë në vitin 2019. Duke marrë në konsideratë, se ky u konsultua njëherë, dhe vetëm për shkak të dakordësisë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, u miratua në 2020, u vlerësua jo i nevojshëm të ri hidhej në sistem për konsultim publik. Për këtë projektakt nuk pati komente.

3. Projektligji "Për Autoritetin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore dhe detare"- është një akt i mbartur, dhe konsultimi publik për këtë akt është bërë në vitin 2019. Duke marrë në konsideratë, se ky u konsultua njëherë, dhe vetëm për shkak të dakordësisë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, u miratua në 2020, u

vlerësua jo i nevojshëm të ri hidhej në sistem për konsultim publik. Për këtë projektakt nuk pati komente.

4. Projektligj "Për ndarjen e Hekurudhës Shqiptare sh.a"- është një akt i mbartur, dhe konsultimi publik për këtë akt është bërë në vitin 2019. Duke marrë në konsideratë, se ky u konsultua njëherë, dhe vetëm për shkak të dakordësisë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, u miratua në 2020, u vlerësua jo i nevojshëm të ri hidhej në sistem për konsultim publik. Për këtë projektakt nuk pati komente.

5. Projektvendimi "Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit. Ky projektakt duke marrë në konsideratë se është projektvendim nuk është listën shteruese për të cilën është i detyruar konsultimi publik (projektligj/strategji). Megjithatë ky është në publikuar në faqen zyrtare të MIE-es, si dhe është diskutuar/konsultuar me kompanitë dhe institucione të tjera të interesuara.

6. Projektvendimi "Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave Ky projektakt duke marrë në konsideratë se është projektvendim nuk është listën shteruese për të cilën është i detyruar konsultimi publik (projektligj/strategji).

Përgjatë vitit 2020, MIE ka realizuar pjesërisht planin e saj të konsultimit.

Këto projektakte të konsultuara gjatë vitit 2021, ishin të parashikuar në Planin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) 2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 837, datë 24.12.20, "*Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020*", i ndryshuar me VKM nr. 150, datë 19.2.2020.¹

Gjatë periudhës së monitorimit, pra për periudhën Janar-Dhjetor 2020, janë miratuar ndër të tjera dhe projektakte të tjera të fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të parashikuara në PPAP 2020, për të cilat nuk u zhvillua procesi i konsultimit publik, pasi nuk janë në fushën e zbatimit të Ligjit nr. 146/2014 "Për konsultimin Publik". (Shtojca 1 bashkëlidhur).

Gjithashtu, në vijim të monitorimit të platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) vihet re se për projektaktet e konsultuara ka pasur një numër vizitorësh në rritje nga publiku (Qytetar/Ekspert) dhe për njërin prej tyre janë përcjellë rekomandime apo komente përmes RENJK, duke patur një numër prej 5060 vizitorësh në total për të gjashta projektaktet për të cilat është zhvilluar konsultimi publik. Ndër të cilët, 2319 i përkisnin kategorisë qytetarë dhe 2741 i përkisnin kategorisë ekspertë. Pra, nga këto të dhëna vlerësohet se ka pasur një interesim të lartë dhe pothuaj të njëjtët ndërmjet qytetarëve/ekspertëve, me një epëresi të lehtë të qytetarëve. Projekaktet të cilat kanë pasur më interes në RENJK për sa i përket numrit të leximeve, kanë qënë **Strategjia Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030 dhe Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025**

¹ Shih në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/837>

Nga procesi i konsultimit publik i realizuar, edhe pse vihet re një përmirësim i ndjeshëm këtij procesi gjatë kësaj periudhe, lind nevoja për një informim më të mirë të këtij procesi ndaj publikut.

Një problematikë që vlen të theksohet është se kemi shumë vizitorë, si nga qytetarë dhe ekspertë por janë të pakët ata që lënë komente qoftë për pyetje, interesim apo sqarime shtesë lidhur me këtë projekta. Megjithatë, qytetarët/ekspertët kanë pasur mundësi dhe rrugë të tjera, si psh e-maile për të përcjellë shqetësimet dhe paqartësitë e tyre.

Por theksojmë se duke filluar nga marsi 2020 situata e pandemisë COVID 19 ka ndikuar në një pjesëmarrje më të ulët.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Numri i përgjithshëm i akteve për të cilin Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kryer konsultim publik gjatë vitit 2020 është 6 (gjashtë) projektakte, konkretisht:

1. Projektligji "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik";
2. "Amendimi i ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar;
3. Projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr.10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
4. Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qendrueshëm të Infrastrukturës Digjitatele Broadband 2020-2025";
5. Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030";
6. Projektligj "Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të kënaqësisë me motorr me fuqi mbi 30 KË ose 40.8 KF dhe tonazh nën 150 GT"

Pra, MIE ka planifikuar për konsultim 25% të akteve të PPAP në përputhje dhe me detyrimet për konsultim, sipas ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Për sqarimet e lartpërmendura, MIE realizoi konsultim publik të mirëfilltë vetëm për 6 prej tyre, pra 16 % të akteve të PPAP. Por sic u theksua dhe më sipër për 4 për këto projekta duke marrë në konsideratë që ishin akte të mbartura nga PPAP 2019, dhe ishte zhvilluar njëherë konsultimi publik për ato, nuk u velrësua e nevojshme të ribëhej, duke qënë se dhe komente nuk kishte pasur herën e parë, dhe gjithashtu draftet e tyre skishin ndryshuar. Gjithashtu, vlen të theksohet se për dy dokumente strategjik, megjithëse se janë projektvendime dhe si e tillë nuk janë në listën shteruese për të cilën është i detyruar konsultimi publik (projektligj/strategji), ato janë publikuar në faqen zyrtare të MIE-es, si dhe është diskutuar/ konsultuar me kompanitë dhe institucione të tjera të interesuara. Projektaktet si më poshtë:

1. Projektvendimi "Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit.

2. Projektvendimi “Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave”

Në mbështetje të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projektdokumentet strategjike kombëtare dhe vendore. Për këtë arsye, konsultimi publik është parashikuar të realizohet vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t’iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1 të ligjit të lartpërmendur. Ndërsa në nenin 4 të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” është parashikuar lista e projektakteve që nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, siç janë çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekretet shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative të KM me fuqinë e ligjit, emergjenca civile dhe çështje të tjera të parashikuara me ligj.

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

MIE ka miratuar 163 akte në vitin 2020, ndër të cilat vetëm 36 prej tyre ishin të parashikuara në PPAP 2020.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Gjashtë projektakte i janë nënshtruar konsultimit publik. Pra, nga aktet e planifikuara për t’u konsultuar gjatë kësaj periudhe raportimi, janë konsultuar 16% e tyre. Theksojmë se aktet e tjera që nuk janë konsultuar janë pjesë e përjashtimeve të përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Janë konsultuar 4 ligje me raporte VNR.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Nuk janë konsultuar akte të cilat janë pjesë e përjashtimeve të përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

6 projekakte, ndër të cilat 4 projektligje, dhe 2 projektvendime (1 strategji dhe një dokument strategjik kombëtar).

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Situata është përmirësuar, dukshëm, dhe vlerësohet në raport me interesimin e qytetarëve/qytetarëve të cilët janë pjesëmarrës aktive në konsultimet publike, të cilët jo vetëm nëpërmjet komnetve, por kanë marrë pjesë dhe në takimet publike në MIE që realizuar me këtë qëllim.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. *Cilat ishjin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishjin 3(tre):

1. konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik,
2. tryeza të konsultimit me ekspertë,
3. nëpërmjet faqes zyrtare të Ministrisë duke kontaktuar me adresën e emailit të personave të kontaktit.

2.2.2. *Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit. Numri i komenteve përmes konsultimit publik nëpërmjet regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike ishte 1 (një) dhe përmes konsultimit me ekspertë të realizuara nga grupi i punës për hartimin e projektave ishte 16 dhe asnjë koment përmes publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

2.2.3. *A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Po, nga ana e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave, në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Hartimit të Legjislativës, janë zhvilluar takimet përkatëse për konsultimin publik, konkretisht më datë 11.09.2019, janë zhvilluar takimet për projektvendimin "Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030", me 60 (gjashtëdhjetë) ekspertë të fushës, përfaqësues nga GIZ/ERRU, përfaqësues të Bashkive, etj.

Në 5 Korrik 2019, për projektvendimin "Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qendrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025", në ambientet e MIE, u mbajt një konsultim shumëpalësh, përfshirë këtu një tavolinë e rumbullakët me aktorët e ndryshëm si dhe një pyetësor dërguar këtyre të fundit si: Operator Telekomunikacioneve, Institucione Shtetërore, Bashkitë, donatorë etj.

Në nëntor 2019, drafti i dokumentit është prezantuar në takimin e Grupit Tematik të Telekomunikacionit dhe Broadband të drejtuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me pjesëmarrje të përfaqësuesve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, operatorëve të telekomunikacionit etj., drafti ju kalua për mendim pas takimit në rrugë elektronike insitucioneve, operatoreve etj.

Në 21 janar 2020, është organizuar një seminar për prezantimin dhe diskutimin për çështjet e zhvillimit të infrastrukturës broadband në kuadër të projektit për studimin e fizibilitetit për zhvillimin e broadbandit rajonal me të gjitha palët e përfshira dhe rolin e bashkive.

Gjithashtu, për projektligjin "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", në shkurt 2020 u zhvillua një takim me ekspertët e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrinë për Infrastrukturën dhe Energjinë ku u diskutua për draftin e projektligjit. Gjate muajit mars-prill

janë bërë disa komunikime me institucionet e lidhura me zbatimin e të dhënave të hapura si me AKSHI, ASIG, etj.

Por theksojmë se në periudhë Mars 2020 dhe në vijim situata e COVID 19 ka ndikuar në një pjesëmarrje më të ulët.

Pra, për pjesën më të madhe projektakteve, janë zhvilluar disa konsultime paraprake.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditëpune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për të gjashta aktet e planifikuara gjatë të vitit 2020 u realizua në përputhje me ligjin nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij. Konsultimet patën një kohëzgjatje prej 20 ditësh nga data e publikimit, si vijon:

- për projektligjin "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik"; filloi më datë 20.05.2020 dhe u mbyll më datë 17.06.2020;
- për projektvendimin “Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025”, filloi më datë 16.04.2020 dhe u mbyll më datë 27.05.2020;
- për projektvendimin “Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030”, filloi më datë 24.01.2020 dhe u mbyll më datë 20.02.2020;
- për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar”; filloi në datë 7.12.2020
- për projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesat në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”- filloi më datë 30.07.2020
- për projektligjin “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të kënaqësisë me motor me fuqimbi 30 KË ose 40.8 KF dhe tonazh nën 150GT”- filloi më datë 02.07.2020

Projektligji “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik” i është nënshtruar më së pari një procesi konsultimi paraprak. Ky është realizuar më datë 20.02.2020 me ekspertët e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe me përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjinë, grupet e interesit, etj.ku u diskutua për draftin e projektligjit. Projekt ligji është hedhur për konsultim publik në portalin e konsultimeve Publike: nga data 20.05.2020 – 17.06.2020.² Gjithashtu projektligji është publikuar për konsultim të hapur në të njëjtën periudhë në faqen e MIE.

Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është zhvilluar procesi i konsultimit publik nëpërmjet publikimit të projektvendimit “Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025”, më datë 16.04.2020-27.05.2020, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (në nivel eksperti dhe qytetari), si dhe nëpërmjet publikimit në faqen e MIE.

² Informacion nga Drejtoria e Politikave të Strategjive dhe Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave

Gjithashtu dhe për projektvendimin “Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030”, nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është zhvilluar procesi i konsultimit publik, pas dhe disa fazash të hershme të konsultimit që datojnë më 11.09.2019, është vijuar më tej me publikimin e projektvendimit më datë 24.01.2020-20.02.2020, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (në nivel eksperti dhe qytetari), si dhe nëpërmjet publikimit në ëëbsite-in e MIE.

Nga të tre projektaktet e sipërpërmendura, periudha më e gjatë për konsultimin publik ka qenë ajo e projektvendimit “Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025”, për rëndësinë që mbart në implementimin e tij.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit përsa i përket fazave paraprake dhe më pas publikimit në RENJK, është 9 (nëntë) muaj.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata nuk ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët.

Dhe pse gjatë vitit 2019 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka rezultuar me një shkallë realizimi të procesit të konsultimit publik shumë të mirë, konstatojmë gjithashtu se situata me këtë proces është përmirësuar në krahasim me vitin apo edhe vitet e mëparshme. Të dhënat e përfutura nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike tregojnë se numri i vizitorëve ka qenë në rritje, pavarësisht faktit se përcjellja e komenteve përmes këtij portali vazhdon të jetë në nivele të ulëta.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Gjatë vitit 2020 aktorët pjesëmarrës ishin kryesisht ekspertë të fushës, përfaqësues të institucioneve shtetërore, Organet Rregullatore, Ministrinë e linjës, Bashkitë, Kompani (Operatorët e telekomunikacioneve në rastin e Broadband) dhe ekspert nga organizata ndërkombëtare. Gjithashtu përsa i përket projektvendimit “Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030”, ka patur dhe përfaqësues të GIZ, si dhe përfaqësues të studios mjedisore ESDO.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Për konsultimin e projektakteve gjatë vitit 2020, pjesëmarrësit në tryezat e konsultimit ishin:

- ekspertë individual,
- përfaqësues nga organet rregullatore,
- përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, dhe jashtë Shqipërisë
- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë.

- përfaqësues nga Bashkitë,
- përfaqësues nga kompanitë si *Operatorët e Telekomunikacioneve*

2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet hapura të realizuar për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Gjatë procesit të konsultimit, kryesisht të gjithë pjesëmarrësit në tryezat e konsultimit dhanë komente dhe sugjerime me qëllim përmirësimin e projektligjeve/projektakteve

2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë kryesisht nga organet rregullatore (AKEP, AMA), *Institucionet Publike: AKSHI, AKCESK, Ministrinë e linjës: MFE, Bashkitë, Ekspert te ITU* persona juridikë privatë.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Konstatohet se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu, edhe nga monitorimi i portalit të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike vërehet një rritje e numrit të qytetarëve që ndjekin projektaktet e publikuara në të, si dhe komentet e dhëna nga ana e tyre mbi këto projektakte. Mjafton të përmendim projektvendimin “Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qendrushëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025”, ka marrë një koment me 7 (shtatë nënpika), koment ly i pranuar pjesërisht, si dhe janë dhënë shpjegime për të tjerat.

2.2 Rekomandimet dhe komentet e marra

Gjatë vitit 2020 rezultojnë komente të mbledhura për të 6 (gjashtë) projekt-aktet e konsultuara

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë përmes tryezave të konsultimit të zhvilluara në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe përmes e-maileve, komente për secilin projektakt të konsultuar.

2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Komentet janë pranuar pjesërisht, duke dhënë shpjegimet përkatëse në rastet që nuk janë pranuar.

2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Konstatohet se tendenca është përmirësuar ndjeshëm.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Nuk janë përditësuar, sepse nuk ka pasur komente që cenonin VNR në mënyrë të tillë që duhet të ndryshoheshin.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Për vitin 2020 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka publikuar asnjë raport konsultimi, por kanë pjesë e paketës së projektit që është dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave.

2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsytet?*

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

*Duke marrë në konsideratë metodologjinë e pikëzimit, sqarohet se për projektet për të cilat MIE ka realizuar konsultim publik vlerësojmë se indeksin e cilësisë së performancës është 8, për të gjitha aktet e konsultuara nga MIE. **Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit të qeverisë, është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit; janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre, në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara***

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Për sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik mund të përmendim gjithpërfshirjen e publikut, duke bërë të mundur dhe një angazhim më të madh nga ana e tij në këtë proces. Me qëllim përmirësimit të procesit të konsultimit publik, sugjerohet organizimi i konsultimeve përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik.

Shtojca 1. Lista e projektakteve të miratuara për periudhën janar-qershor 2020, të përfshira në PPAP 2020

1. Projektvendimi “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 368, datë 20.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit:

‘Rikualifikimi në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë’, i parashikuar në PPA 2020-katër mujori I, është miratuar me VKM nr.23, datë 15.01.2020.

2. Projektvendimi “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti: “Rrugët përgjatë Bregut Jugor të Rezervuarit të Banjës”, i parashikuar në PPA 2020-katër mujori I, është miratuar me VKM nr.25, datë 15.01.2020.
3. Projektvendimi “Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave, të njëjësive dhe të elementeve të ndërtesave”, i parashikuar në PPA 2020 – katër mujori I, është miratuar me VKM-në nr. 256, datë 27.3.2020.
4. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar”, i parashikuar në PPA 2020-katër mujori I, është miratuar me Ligjin nr. 11/2020, datë 12.02.2020.
5. Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020–2025”, i parashikuar në PPA 2020 – katër mujori I, është miratuar me VKM nr.434, datë 3.06.2020.
6. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.599, datë 23.7.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e pagesave që kryhen në autoritetin e komunikimeve elektronike dhe postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike”, të ndryshuar, i parashikuar në PPA 2020 – katër mujori I, është miratuar me VKM nr.334, datë 22.04.2020.
7. Projektvendimi “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës ‘Isuf Balta’, Tiranë”, i parashikuar në PPA 2020-katër mujori I, është miratuar me VKM nr.97, datë 5.02.2020.
8. Projektvendimi “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugëve, trotuareve dhe ndriçimit në lagjen “30-vjetori” (Zona e ish pjeshkores)”, Berat, i parashikuar në PPA 2020-katër mujori I, është miratuar me VKM nr.255, datë 27.03.2020.
9. Projektvendimi “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 462, datë 10.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i rrugës ‘Dhimitër Konomi’, në zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë””, i parashikuar në PPA 2020-katër mujori I, është miratuar me VKM nr.255, datë 27.03.2020.
10. Projektvendimi "Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të

Gjermanisë për Bashkëpunim Teknik 2019 për projektin “Për një transport publik udhëtarësh miqësor me mjedisin në metropolin e Tiranës”, i parashikuar në PPA 2020-katër mujori I, është miratuar me VKM nr.303, datë 15.04.2020.

11. Projektvendimi "Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut në Lidhje me Shërbimet Ajrore", i parashikuar në PPA 2020-katër mujori I, është miratuar në parim në KM.
12. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e ndryshuar të Organizatës Europiane të Telekomunikacioneve Satelitore (EUTELSAT)”, i parashikuar në PPA 2020-katër mujori I, është miratuar me Ligjin nr. nr. 83/2020, datë 02.07.2020.
13. “Për miratimin, në parim, të Dokumentit të Ndryshimit të Marrëveshjes së Huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për Rimëkëmbjen e Sektorit të Energjisë Elektrike, ratifikuar me Ligjin nr.170/2014.
14. “Për disa ndryshime në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i republikës së shqipërisë”, të ndryshuar
15. Projektvendim "Për Kriteret dhe procedurat për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë” të ndërtesave";
16. Projektvendim "Për miratimin e Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes së Performancës së Energjisë në ndërtesa"
17. Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Mbi metodologjinë për llogaritjen e niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave, njësisive dhe elementeve të ndërtesave"

